

Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 66

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësime të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

Kapitulli: Mbrojtja paraprake e teuhidit dhe mbyllja e rrugëve të shirkut

Abdullah Ibn Esh-Shihiri¹ (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Isha me delegacionin e Benu Amrit, kur shkuam te Profeti i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe i thamë: “Ti je Madhëri (*Sejiduna*) për ne!”. Ai na tha: “Madhëri (*Es-Sejid*) për ne është Allahu i Lartësuar”. Atëherë ne i thamë: “O më i miri, më i nderuari dhe më bujari nga ne”. Ai na e ktheu: “Thoni ato fjalë që thatë, ose disa prej fjalëve që thatë, por mos e lini shejtanin që t’ju tërheqë pas vetes”².

Nga Enesi përcillet: “Njëherë, disa njerëz i thanë Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): “O i dërguari i Allahut, o më i miri ynë dhe biri i më të mirit tonë! O zotëria ynë dhe biri i zotërisë tonë!”. Ai ua ktheu: “O njerëz, thoni fjalët që thatë, por mos e lini shejtanin që t’ju bëjë për vete! Unë jam Muhamedi, robi i Allahut dhe i dërguari i Tij. Nuk dua që të më ngrini më lart se grada ku më ka ngritur Allahu i Madhëruar”³.

Dobitë e temës

- Paralajmërimi i njerëzve për t’u ruajtur nga teprimi.
- Si duhet të reagojë ai të cilit i thuhet “ti je zotëria ynë”.
- Vërejtja e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): “... mos e lini shejtanin që t’ju tërheqë pas vetes...”, edhe pse ata thanë vetëm të vërtetën.
- Thënia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): “Nuk dua që të më ngrini më lart se grada ku më ka ngritur Allahu i Madhëruar”.

Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e ruajti teuhidin dhe i respektoi kufijtë e tij. Ai mbylli çdo derë që të çon në shirk. Në Sunetin e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka më shumë se njëqind argumente dhe rregulla, që i mbyllin derën çdo të keqe. Dera më e madhe që duhet mbyllur është dera e shirkut dhe çdo gjë që

¹ Ai është Abdullah Bin Esh-Shihiri Bin Auf Bin Ka’b El Amirij, Ebu Mutarrif, sahab. Ka banuar në Basra dhe prej tij kanë transmetuar dijetarët e hadithit, përveç Buharit.

² E shënon Ebu Daudi (4806), Buhariu në “Edebul Mufred”f.83 nr. 211).

³ E shënon Nesaiu në “El Kubra” (6/70 ne.10077), dhe Ahmedi (3/153 nr.12551).

të çon atje. E tillë është thënia: “O më i miri ynë dhe biri i më të mirit tonë! O zotëria ynë dhe biri i zotërisë tonë!” etj. Në këto shprehje ka një lloj madhërimi, i cili nuk lejohet që t’i bëhet ndonjë njeriu. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është zotëria i bijve të Ademit, ashtu siç ka lajmëruar Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), por ai e urreu që t’ia thoshin këtë.

Mbrojtja që i bëri Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) kufirit të teuhidit ishte nga ana e besimit, fjalëve dhe e veprave. Nëse do ta shikosh me vëmendje Sunetin e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe çka ka ardhur në këtë libër, do të gjesh se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ia ka mbyllur derën besimeve të kota dhe veprave të kota, siç thotë: “Allahu hidhërohet shumë me ata njerëz që varret e profetëve të tyre i bëjnë xhami (vend falje)”. Ai ia ka mbyllur derën edhe fjalëve të cilat të çojnë në tejkalimin e caqeve, siç thotë: “Mos e teproni në lavdërimin tim, siç e tepruan të krishterët me të Birin e Merjemes. Unë jam vetën një rob, prandaj thoni ‘Rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij’⁴.”

Edhe ky kapitull qartëson se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i ka mbrojtur kufijtë e teuhidit dhe në çdo gjë që ka lidhje me të dhe me besimin. Abdullah Ibn Esh-Shihiri⁵ (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: “Isha me delegacionin e Benu Amrit, kur shkuam te Profeti i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe i thamë: “Ti je Madhëri (Sejiduna) për ne!”. Ai na tha: “Madhëri (Es-Sejid) për ne është Allahu i Lartësuar”. Atëherë ne i thamë: “O më i miri, më i nderuari dhe më bujari nga ne”. Ai na e ktheu: “Thoni fjalët që thatë, ose disa prej fjalëve që thatë, por mos e lini shejtanin që t’ju tërheqë pas vetes”⁶. Ky hadith tregon se është e urryer t’ia thuash njerëzve shprehjen “Es-sejid”, dhe se përdorimi i kësaj shprehje nuk duhet bërë. Askujt të mos i drejtohesh me ‘zotëria ynë’ në numrin shumë, sepse ky është madhërim i atij që po ia drejton këtë shprehje drejtpërdrejt.

Ana tjetër është përdorimi i kësaj shprehjeje. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është zotëri, ashtu siç ka thënë për veten e tij: “Unë jam zotëria e bijve të Ademit ditën e Kijametit”⁷. Megjithëkëtë Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e urrente t’ia thoshin këtë dhe e ka ndaluar këtë, me qëllim që të mos arrinin tek diçka që është më e rëndë se kjo, siç është madhërimi i tij dhe teprimi në lavdërimin e Tij (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

⁴E shënon Buhariu (3445) dhe Muslimi (1691)

⁵ Ai është: Abdullah Bin Esh-Shihiri Bin Auf Bin Ka’b El Amirij, Ebu Mutarrif, sahabij, ka banuar në Basra, prej tij kanë transmetuar dijetarët e hadithit, përveç Buharit.

⁶E shënon Ebu Daudi (4806), Buhariu në “Edebul Mufred”f.83 nr. 211).

⁷E shënon Muslimi (2278) nga hadithi i Ebi Hurejres (Allahu qoftë i kënaqur me të).

Përshtatshmëria e këtij hadithi me këtë libër është fjala e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): “**Madhëri (Es-Sejid) për ne është Allahu i Lartësuar**”. Megjithëse Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) është zotëria i bijve të Ademit, ai i mbrojti kufijtë e teuhidit dhe mbylli çdo derë që të çon në shirk, e prej këtyre është tejkalimi në shprehje.

Kur i drejtohesh dikujt duke i thënë ‘zotëria ynë’ është më madhe se kur ia thua në numrin njëjës, ‘zotëria im’.

Dijetarët kanë thënë se fjala e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) “**Madhëri (Es-Sejid) për ne është Allahu i Lartësuar**” tregon se është shumë e urryer që t’i thuhet një njeriu “Es-Sejid” (zotëri), kur është në trajtën e shquar, sepse mund të mbartë kuptimin e “zotërimit”, kurse njerëzit nuk zotërojnë në mënyrë të pavarur. Prandaj disa njerëz të cilët bëjnë shirk, sikur janë ata që shkojnë tek “Sejid El Bedevij”, e madhërojnë fjalën “Es-Sejid” dhe e adhurojnë atë njeri. Kur e thonë këtë fjalë, ata kanë për qëllim atë “Sejid El Bedevij”. Ata e përdorin shumë fjalën: “Abdu Es-Sejid” / rob i Sejdit. Me këtë fjalë, ata nuk kanë për qëllim Allahun e Lartësuar, por kanë për qëllim atë të cilin e adhurojnë. Ata i drejtohen atij me disa lloj adhurimesh. Ata, me fjalën “Es-Sejid”, besojnë se ai ka zotërim dhe se ka mundësi të veprojë në univers. Ata besojnë se “Sejid Bedevij” dhe të tjerë si ai kanë fuqi të veprojnë edhe në tokë, duke i plotësuar nevojat dhe kërkesat e tyre.

“Atëherë ne i thamë: “O më i miri, më i nderuari dhe më bujari nga ne”. Ai na e ktheu: “**Thoni fjalët që thatë, ose disa prej fjalëve që thatë, por mos e lini shejtanin që t’ju tërheqë pas vetes**”.

Në këtë shprehje ka lavdërim dhe ajo iu tha në publik. Kjo është prej shejtanit, sepse shejtani është ai që e hap këtë derë, pra të lavdërohet dhe të madhërohet në prezencë të njerëzve, derisa të arrijë tek madhërimi i vetvetes dhe në fund të poshtërohet. Të gjithë ata që heqin dorë nga fjala “*La haule ue la kuvete ila bil-Lah*” / (Nuk ka fuqi dhe pushtet për asgjë veçse me ndihmën e Allahut të Lartësuar) dhe heqin dorë nga nënçmimi i vetes, nënshtrimi dhe përulja në zemër, realitetin e të cilave Allahu ua njeh, këta njerëz do të zhgënjehen dhe atyre do t’u vijë poshtërimi nga nuk e presin. Prandaj Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e ndaloi që kjo fjalë t’i thuhet dikujt apo të lavdërohet dikush në publik, sepse kjo e dëmton atë që lavdëron dhe të lavdëruarin.

Nga Enesi përcillet: “Njëherë, disa njerëz i thanë Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): “O i dërguari i Allahut, o më i miri ynë dhe biri i më të mirit tonë! O Zotëria ynë dhe biri i Zotërisë tonë!”. Ai ua ktheu: “**O njerëz, thoni fjalët që thatë, por mos e lini shejtanin që t’ju bëjë për vete! Unë jam Muhamedi, robi i Allahut**”.

dhe i dërguari i Tij. Nuk dua që të më ngrini më lart se grada ku më ka ngritur Allahu i Madhëruar”⁸.

Ashtu siç e kanë përshkruar, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ishte vërtet më i miri i tyre dhe zotëria i tyre, por ai i mbrojti kufijtë e teuhidit. Kështu nuk ka askush mundësi të argumentohet pas Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) me këto fjalë dhe të thotë se dikush tjetër i meriton këto. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) e mbylli këtë derë për veten e Tij, duke qenë zotëria i bijve të Ademit, që askush mos ta veprojë këtë gjë. Pra, e bëri që dikush të mos madhërojë njeri dhe t’i vijë shejtani dhe t’ia shtojë atij madhërimin, derisa të bëjë shirk.

Ky kapitull është gjithëpërfshirës dhe mbyll çdo derë që çon në shirk. Është detyrim për çdo musliman që të mbyllë çdo rrugë që e bën atë të madhërojë veten. Më e larta pozitë për njeriun është që të jetë i nënshtruar ndaj Allahut, i frikësuar ndaj Tij, t’i lutet Atij me frikë dhe me shpresë. Këto cilësi i ka një pakicë e vogël njerëzish nga robërit e sinqertë të Allahut të Lartësuar, të cilëve u janë premtuar mirësi. Allahu i Lartësuar thotë: “Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë dhe ishin të përlurur ndaj Nesh”⁹.

Frika është dy llojesh: frikë në zemër dhe frikë në gjymtyrë. Frika me zemër është kur i përulësh dhe i nënshtrohesh Allahut të Lartësuar. Frika në gjymtyrë është kur ato janë të qëndrueshme e të qeta. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ndër shenjat e Tij është edhe ringjallja e tokës, kur Ti e sheh tokën të thatë e të shkretë”.¹⁰

⁸ E shënon Nesaiu në “El Kubra” (6/70 ne.10077), dhe Ahmedi (3/153 nr.12551).

⁹ EL-ENBIJÂ’ : 90

¹⁰ FUSSILET : 39